



Shtime, 6. 9. 2023
Nr. 02/769

RAPORTI

i dëgjimeve publike për

KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2024-2026

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në nenin 9 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt).

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shites, Npi-01/206 të datës 31.05.2023, për të nxjerr në diskutim publik Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 dhe neneve 14-21 të Statutit të Komunës së Shites, 01 R. 006/10911-144, datë 30.04.2014.

Linku në ueb-faqen e komunës:

<https://kk.rks-gov.net/shitime/>

Linku në rrjetin social Facebook:

<https://www.facebook.com/officialKomunaShitime/>

Të gjithë banorët e fshatrave dhe lagjeve, drejtorë të shkollave, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të mediave, janë njoftuar me kohë.

Në këtë dëgjim me publikun për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2024-2026 parashihet evidentimi i kërkesave prioritare të banorëve të fshatrave, përfaqësuesve të lagjeve, shoqërisë civile mediave për ato projekte që ata i cilësojnë si më jetike për të rritur mirëqenien sociale dhe lehtësuar jetën e qytetarëve tanë.

Metodat e konsultimit	Data /Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	F	M	Numri i komenteve, kërkesave, sugjerimeve	Numri i kërkesave të pranuar
Takimi i drejtpërdrejtë me të gjithë qytetarët e komunës së Shites të organizuar nga Kryetari i Komunës dhe grupi punues për dëgjimet buxhetore	Nga : 13.06.2023 Deri më 21.06.2023	201	6	195		203

Të gjitha kërkesat e parashtruara në dëgjim publik janë pjesë e raportit.

Vendi i takimit	Data	Ora
Në shkollat e çdo fshati të komunës së Shites	Nga: 13.06.2023 deri me 21.06.2023	Nga ora 16:00

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës /sugjerimi i pranuar ,pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
1.	Hapësira për bizneset dhe infrastruktura janë dy elementet kryesore dhe më të rëndësishme sa i përket bizneseve. Infrastruktura nuk është në nivelin e duhur, rrugët kanë filluar të prishen, rrugët të cilat na lidhin me qytetet e mëdha janë në gjendje jo të mirë, tranziti më është jashtë funksionimit.	Rexhep Limani nga Bizneset	Plotësisht	Sa i përket hapsirës jemi në përfundim e sipër të parkut të biznesit në Gllavicë dhe besojmë që së shpejti ajo pjesë do të jetë në shfrytëzim. Ndërsa sa i përket tranzitit vetëm sa nuk ka filluar rregullimi i tij dhe besoj që do të jetë një lehtësim i madh si për ju ashtu edhe për të gjithë banorët e Shtimes.
2.	Rruga tek parku i biznesit ka filluar të prishet ku si pasojë e kësaj janë disa gropa të mëdha të cilat e vështirësojnë transportin. Sa i përket stinës së dimrit mjetet me vështirësi të madhe ngjiten në atë pjesë të rrugës prandaj nëse është mundësia të bindni operatorin për të shtrirë kripë ose gurë më shumë, gjithashtu edhe pastrimi i borës të bëhet më shpesh.	Bekim Sinani nga Bizneset	Plotësisht	Sa i përket rrugës tek parku i biznesit këtë vit do të rregullohet.
3.	Të bëhet një muri mbrojtës për shkak se ka shembje të dheut. Një shtyllë afër objektit po shfaqë problem edhe e njëjta është në rrezik të bie	Isa Laçi nga Bizneset	Plotësisht	Do të marrim masa sa i përket këtyre kërkesave.
4.	Të rregullohet kanalizimi në të gjithë fshatin	Ismet Fazlija banor i fshatit Carralevë	Pjesërisht	
5.	Të rregullohet kanalizimi dhe ujësjellësi, të mirëmbahen trotualet, rregullimi i rrugës Carralevë-Zborc, rregullimi i rrugës te varrezat si dhe të vendosen patrolla të policisë	Tahir Qerkini banor i fshatit Carralevë		
6.	Në lagjen e "Behovitëve", të vendosen trotuare dhe ndriqim	Besnik Beha banor i fshatit Carralevë	Plotësisht	
7.	Në lagjen "Balaj", të rregullohet kanalizimi, si dhe të bëhet rivitalizimi i rrugës	Lulzim Balaj banor i fshatit Carralevë		
8.	Të rregullohet ndriqimi tek lagja "Hasani"	Festim Hasani banor i fshatit Carralevë	Plotësisht	
9.	Në rrugën "Rrahman Tafa", të rregullohet kanalizimi	Arben Fazliu banor i fshatit Carralevë	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete të futet në këtë buxhet
10.	Të lëshohet shkolla e re si dhe të ketë ndonjë park apo terensporti	Safet Hajrizi banor i fshatit Carralevë	Plotësisht	

11.	Të rregullohet një segment në rrugën 'Ibrahim Rugova'	Lutfi Zeqiri banor i fshatit Davidovc	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete të mjaftueshme për këtë projekt
12.	Të rregullohet kanalizimi në rrugën 'SmajlGorani', afër rrugës 'Azizi'	Drilon Azizi banor i fshatit Davidovc	Plotësisht	
13.	Të rregullohet trotuari nga rruga 'Smajl Gorani', deri te rruga 'Demokracia', dhe të bëhet hapja e kanaleve atmosferike	Ilmi Sadriu banor i fshatit Davidovc	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete të mjaftueshme për këtë projekt
14.	Tek rruga kryesore të ketë një pengesë ose shenjë rrezikshmërie për fëmijët në shkollë	Isuf Ajeti banor i fshatit Davidovc	Pjesërisht	Kjo rrugë është kompetencë e Ministrisë, por ne do ta bëjmë një kërkesë për nënkalim
15.	Probleme me ndriqim dhe kanalizim, vazhdimin e rrugës 'Imer Syla' me asfalt deri në Rashincë si dhe rregullimin e trotuarit 400 metra	Amir Shabani banor i fshatit Davidovc	Plotësisht	Ndriçimi dhe kanalizimi do të futet në buxhet
17.	Të rregullohet rruga tek lagjia 'Emini'	Milazim Emini banor i fshatit Davidovc	Plotësisht	
18.	Tek Xhamia të zgjerohet parkingu (me një parcelë e cila është pronë e Xhamisë)	Bunjamin Emini banor i fshatit Davidovc	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete për vitin 2024
19.	Kërkesë tek KEDS për shtyllat elektrike (dritat), të ndërrohen apo rregullohen, por primare të jetë kanalizimi në fshat	Elmi Baftiu banor i fshatit Davidovc	Plotësisht	

20.	Lagjja te "Gurët", nr. 44, lagjja "Gashi" nr. 30, lagjja "Krasniqtë", lagjja "Hoxhtë" rrugët të rregullohen me asfalt. Të rregullohet trotuari prej rrugës kryesore deri tek oborri i shkollës. Probleme me ujësjellës tek lagjja "Gashi". Të bëhet një park në Gllavicë, si dhe kërkesa e fundit rruga "MuhametGashi" të asfaltohet.	Shaban Krasniqi banor i fshatit Gllavicë	Plotësisht	
21.	Të rregullohet kanalizimi dhe asfalti në lagjen "Sopjani"	Ali Hyseni banor i fshatit Godanc	Nuk është pranuar	Kanalizimi në atë lagje ka një kosto të madhe dhe presim që të kemi një projekt të përbashkët me ndonjë Ministri
22.	Të zgjerohet rruga "Muhaxheria" ose të bëhet me trotuar	Nebih Maksuti banor i fshatit Godanc	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete për këtë projekt në vitin 2024
23.	Të rregullohet kanalizimi dhe asfalti në rrugën "Agron Ramadani" si dhe ndriqimi sipas mundësive	Adem Ramadani banor i fshatit Godanc	Plotësisht	
24.	Të pastrohet Lumi (prej pjesës së urës e lart) në rrugën "Besëlidhja"	Hysni Rashiti banor i fshatit Godanc	Plotësisht	
25.	Në rrugën "Gashi" dhe "Topilla" të bëhen me trotuar	Qlirimtar Misini banor i fshatit Godanc	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete buxhetore për vitin 2024
26.	Të asfaltohet rruga "Dardania" dhe të rregullohet ura	Bashkim Ramadani banor i fshatit Godanc	Plotësisht	

27.	Të asfaltohet rruga "Dardania"; të rregullohen trotualet dhe ndriqimi, gjithashtu të vendosen edhe tabela për emërtimin e rrugëve	Beqir Sadiku banor i fshatit Godanc	Plotësisht	
28.	Në rrugën "Reçica" të rregullohet ndriqimi 280 metra si dhe të rregullohet kanalizimi	Izet Ahmeti banor i fshatit Godanc	Plotësisht	
29.	Renovimi i shkollës dhe ndriqimi në shkollën e Godancit si dhe të vendosen kamerat.	Bashkim Ramadani banor i fshatit Godanc	Plotësisht	Shkolla është duke u renovuar
30.	Rregullimi i rrugës kryesore e cila i lidh disa lagje, gjithashtu rregullimi i rrugës kryesore në Shtime. Zgjerimi i rrugës dhe rregullimi i trotuarit në rrugën Besim Sopa (por ky rregullim i trotuarit të mos bëhet me kubëza por me asfalt pasi është më i qëndrueshëm. Rregullimi i rrethojave të shkollës, pasi mos rregullimi i tyre sjell rrezik për nxënësit. Rregullimi i ndriqimit në rrugën Kastrati. Rregullimi i kanalizimit në lagjen Hoxhaj.	Nazif Sadriu banor i fshatit Gjyrkoc	Plotësisht	
31.	Rruga nga Hoxhë Sinani e deri në Godanc është e shtruar me zhavor, por një pjesë e saj e cila e përfshin lagjen tonë nuk është shtruar andaj kërkoj rregullimin e saj pasi po ndihemi të diskriminuar. Rregullimi i ndriqimit dhe rregullimi i trotuarit në lagjen Hoxhë Sinani. Asfaltimi i rrugës nga shtëpia e Beqir Hoxhës deri tek varrezat.	Hysen Hoxha banor i fshatit Gjyrkoc	Plotësisht	
32.	Tensioni i ulët i rrymës i cili dëmton pajisjet elektrike në mbarë fshatin. Rregullimi i hapësirave të varrezave. Rruga e varrezave që del te pjesa e Hoxhë Sinanit të kthehet në gjendjen e mëparshme. Rregullimi i parkingut para shkollës (me kubëzat e mbetura nga shtrimi i trotuareve).	Xhafer Ahmeti banor i fshatit Gjyrkoc	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete për vitin 2024
33.	Të rregullohet rrethi në lagjen e Pajtimit, fusha e shkollës të rrafshohet me dhe si dhe të bëhet një fushë e re e sportit dhe të bëhet një depo tek shkolla.	Xhevat Krasniqi banor i lagjes së Pajtimit	Plotësisht	

34.	Të rregullohet ndriqimi tek varrezat e lagjes.	Nuhi Ugzmajli banor i lagjes së Pajtimit	Plotësisht	
35.	Të rregullohet rruga "Ohri".	Refki Kadria banor i lagjes së Pajtimit	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete të mjaftueshme në vitin 2024
36.	Kërkesë që të rregullohet kanalizimi në të gjithë fshatin.	Shaban Gashi banor i fshatit Pjetërshticë	Plotësisht	
37.	Të rregullohet kanalizimi në rrugën "Aziz Dugolli"	Jakup Gashi banor i fshatit Pjetërshticë	Plotësisht	
38.	Të rregullohet lumi me gurë ose beton (Lumi Drenica), dhe të asfaltohet rruga "Shaqë Dugolli", në gjatësi 80 metra (lagjja Musolli)	Hafir Dugolli banor i fshatit Pjetërshticë	Pjesërisht	Nuk kemi mjete për rregullimin e shtratit të Lumit
39.	Ujësjetësi dhe kanalizimi të rregullohen në të gjithë fshatin	Rexhep Gashi banor i fshatit Pjetërshticë	Nuk është pranuar	Ujësjetësi është kompetencë e KRU Prishtina por ne do të bëjmë kërkesë në Komunë
40.	Të rregullohet rruga "Maliqi"	Kadri Gashi banor i fshatit Pjetërshticë	Plotësisht	

41.	Rruga nga ura e fshatit deri tek Kroni të ndriqohet dhe të pajiset me trotuar	Musli Musolli banor i fshatit Pjetërshticë	Nuk është pranuar	Nuk kemi mjete të mjaftueshme për këtë projekt në vitin 2024
42.	Rruga "Beqir Bajrami", të asfaltohet në gjatësi 60 metra si dhe të asfaltohen rrugët "Idriz Ajeti" dhe "Agim Dugolli"	Milaim Bajrami banori fshatit Pjetërshticë	Plotësisht	
43.	Shtrati i lumit të rregullohet, ura të cilën e kanë ndërtuar në të kaluarën të demolohehet dhe të sigurohet ndriqimi në të gjithë fshatin Rashincë.	Xhemajl Qorrolli banor i fshatit Rashincë	Pjesërisht	
44.	Renovimi i rrugës "Qorrolli" dhe tek rruga "Canë" të rregullohet uji i cili qëndron përmbi rrugë.	Refki Qorrolli banor i fshatit Rashincë	Plotësisht	
45.	Të bëhet një deponi për mbeturina dhe të ketë më shumë inspektorë në terren. Rruga nga Kosharja në Davidoc të zgjerohet	Sylejman Qorrolli banor i fshatit Rashincë	Plotësisht	E kemi një projekt me Ministri për këtë rrugë
46.	Te lumi tek varret e fshatit, ura të bëhet me gilindera mbrojtës.	Milaim Rushiti banor i fshatit Rashincë	Plotësisht	
47.	Investime në shkollë, shtylla elektrike e cila gjendet afër shkollës të rregullohet, të ndërrohet inventari në shkollë dhe parkingu i shkollës të zgjerohet.	Adil Qorrolli banor i fshatit Rashincë	Plotësisht	

48.	Të bëhet ndriqimi në rrugën "Bora" dhe rrugën "Ibrahim Kodra".	Rinor Haxhiu banor i fshatit Rashincë	Plotësisht	
49.	Në pjesën ku përfundon rruga "Qorrolli" dhe ku lidhet me tranzitin të asfaltohet.	Sali Qorrolli banor i fshatit Rashincë	Nuk është pranuar	Nuk kemi mjete për këtë projekt për vitin 2024
50.	Të rregullohet kanalizimi dhe asfaltimi në rrugën "Rexha".	Enver Rexha banor i fshatit Rashincë	Plotësisht	
51.	Të renovohet shkolla e fshatit dhe të shtrohet asfalti te varrezat	Safet Haziri banor i fshatit Zborc	Pjesërisht	Rruga te varrezat është në projekt
52.	Dy deponi të mbeturinave të hiqen dhe në të njëjtën kohë të sigurohet që nuk do të hedhen më, si dhe të bëhet ndriqimi në tërë fshatin dhe transporti i nxënësve; Të rregullohet ujësjellësi, rruga "1 maji", si dhe tek lagjja e Topillëve (varri i bardhë, prej rrugës "Hafir Bajrami" deri tek rruga e Blinajës) të shtrohen me rrugë të arave;	Valdet Kurti banor i fshatit Zborc	Plotësisht	
53.	Të rregullohet problemi me kanalizim tek lagjja e "Topillëve";	Sali Nuredini banor i fshatit Zborc	Plotësisht	
54.	Te lagjja e "Badraxhinjve", të rregullohet kanalizimi, ndriqimi dhe trotualet. Të shtohen pengesat në rrugë dhe të ketë më shumë patrulla të policisë;	Selman Kadriu banor i fshatit Zborc	Pjesërisht	

55.	Të rregullohet kanalizimi 60 metra në rrugën e Reçakut;	Fadil Xhemajli banor i fshatit Zborc	Plotësisht	
56.	Në rrugën "Qëndresa" të rregullohet kanalizimi dhe asfalti;	Skender Kadriu banor i fshatit Zborc	Plotësisht	
57.	Të rregullohet asfalti në rrugën "Hafir Bajrami", tek lagjja e Topillëve;	Sabit Nuredini banor i fshatit Zborc	Plotësisht	
58.	Tre pengesa të vendosen në hyrje të fshatit, ndriqimi në tërë fshatin dhe të largohen deponitë e mbeturinave;	Idriz Mehmeti banor i fshatit Zborc	Plotësisht	
59.	Të gjitha lagjet e fshatit të pajisen me trotuare.	Sabri Nuredini banor i fshatit Zborc	Pjesërisht	
60.	Të vlerësohen më shumë sportistët të cilët marrin medalje të arta dhe të shpërblehen. Subvencionet të ndahen më herët sa i përket kohës. Sektori për sport të jetë më aktiv, të bëjnë vizita më të shpeshta zyrtarët nga komuna si Kryetari, drejtorët, Kryesuesi që t'iu japin më shumë vullnet sportistëve. Tek salla ku ne i kryejmë stërvitjet është shumë e ngushtë, prandaj do të ishte mire të bëhet një projekt për një sallë për artet marciale. Bizneset e komunës të investojnë më shumë se klubet sportive.	Safet Sylja, kryetari i klubit karatist "Vjosa"	Pjesërisht	
61.	Tek zhveshtoret në palestrën e qytetit të bëhen intervenime dhe të rritet numri i tyre. Të rregullohet ndriqimi tek salla e qytetit pasi që ndriqimi i cili është për momentin më shumë po na dëmton se sa ndihmon.	Arsim Imeri, përfaqësues i klubit hendbollistik "Vjosa" - vajzat:	Pjesërisht	

62.	Ndriqimi nuk funksionon, gjithashtu edhe gjatë sezonës së dimrit nxemjet nuk funksionojnë dhe lojtarët nuk mund të zhvillojnë stërvitje në aso kushte.	Bekim Shahini, kryetari i FC Futsall "Vjosa":	Plotësisht	
63.	Subvencionet të ndahen sipas meritokracisë, në bazë të klubeve që kanë fitues më shumë.	Ramiz Smajli, Klubi i Ciklizmit "Vjosa":	Pjesërisht	
64.	Terren sportive në brendësi të fshatit (te shkolla e vjetër); Rrugë e arave tek Lugu i Bajrakut dhe trotuari ka mbetur në gjysëm tek rruga kryesore dhe duhet të rregullohet; Të marrim pëlqim për rrëzimin e shkollës së vjetër për arsye se qytetarët nuk e dinë a është pronë private apo komunale; Dy shakta të pa mbuluara tek shtëpia e Gazmend Bajramit dhe dytë tjerë afër;	Gazmend Bajrami banor i fshatit Belincë	Plotësisht	
65.	Të rregullohet kanalizimi i cili ka mbetur në gjysëm për 150 ose 200 metra, tek rruga "Pojati";	Ilir Emini banor i fshatit Belincë	Plotësisht	
66.	Dy shakta kulluese tek rruga kryesore tek varrezat;	Nait Shatmani banor i fshatit Belincë	Plotësisht	
67.	Të hapet një kanal në rrugën "Nesret Abazi", kanal për ujëra kullues, shtëpia nr. 47; Të rregullohet ndriqimi në tërë fshatin Belincë (nga shkolla rruga "AfrimMusliu");	Safet Brahimi banor i fshatit Belincë	Plotësisht	
68.	Tek rruga ku gjendet lapidari dhe tokat tona të hapen rrugët e vjetra siç ka qenë rruga e vjetër, të cilën e ka blerë Muhameti por nuk e ka shpronësuar.	Aziz Emini banor i fshatit Belincë	Pjesërisht	

69.	Të rregullohet rruga "Islam Neziraj". Më prioritet për mua në fshatin Mollopolc janë sheshet, ku këto sheshe na përfshijnë të gjithëve. Po ashtu edhe lumin e kemi në gjendje të mjerueshme, prandaj nëse ne dëshirojmë të kemi këtë lum të pastër, duhet që pastrimin ta fillojmë nga Mollopolci, Petrova, Reçaku. Domethënë nëse mirëmbahet dhe investohet këtu besoj që në Shtime uji i lumit do të jetë i pastër.	Reshat Mujota banor i fshatit Mollopolc	Plotësisht	
70.	Një gyp i ujësjellësit në pronën e tij është këputur dhe kërkon nga kompania e ujësjellësit apo Komuna e Shtimes që të rregullohet, meqenëse i nevojitet ajo pjesë për ndërtim; ky problem është në rrugën "Sabri Mujota". I njëjti kërkon që në këtë pjesë të rregullohet edhe kanalizimi.	Mentor Neziraj banor i fshatit Mollopolc	Plotësisht	
71.	Kërkesë për transport për fëmijët të cilët vijojnë shkollën si dhe një transport publik për qytetarët e Mollopolcit. Në rrugën "Abedin Murtezi" të rregullohet ndriqimi dhe trotuari. Gjithashtu për fshatin Mollopolc është i nevojshëm edhe një park, si dhe të bëhet pastrimi i lumit nga rruga apo zona e Nerodimes.	Izjadin Murtezi banor i fshatit Mollopolc	Plotësisht	
72.	Kërkesë të bëhet diçka më inovative, psh. Të bëhet ndonjë park për fëmijë, diçka e përbashkët për tërë fshatin ku të gjithë banorët të mbledhen. Një pyetje nga z. Smajli: Pse nuk është vendosur ndriqimi në rrugën "Abedin Murtezi"?	Naser Smajli banor i fshatit Mollopolc	Plotësisht	
73.	Shkolla nuk ka ujë të pijes. Në rrugën "Hamëz Jashari" të rregullohet trotuari.	Alban Neziraj banor i fshatit Mollopolc	Plotësisht	
74.	Të bëhet rregullimi i prockës e cila po sjell mjaft shumë probleme në rrugët e lagjeve, shpeshherë edhe duke u futur në oborret e shtëpive. Kjo prockë përfshin gjithsej tre lagje të fshatit, duke përfshirë rrugën "Xhemshir Xhemshiri" dhe rrugën "Lumi". Të bëhet një shëtitore nga fusha e futbollit tek Kodra e Mullinit.	Petrit Rexhaj banor i fshatit Petrovë	Pjesërisht	
75.	Të rregullohet kanalizimi.	Gani Ademaj banor i fshatit Petrovë	Plotësisht	

76.	Të vazhdohet trotuari që lidhet me lagjen "Rexhaj" dhe të rregullohet ndriqimi në të njëjtën rrugë, po ashtu të rregullohet kanalizimi në rrugën "Mehdi Korrani". Problem tjetër për fshatin Petrovë është edhe lëvizja e shpeshtë e kamionëve.	Bafti Hysenaj banor i fshatit Petrovë	Pjesërisht	
77.	Të rregullohet kanalizimi në rrugën "Nazmi Bakiu". Të bëhet rregullimi i prockës në lagjen "Rashiti", kërkesë tjetër është edhe rregullimi i shtratit të lumit në të dyja anët. Në pjesën e epërme të rrugës "Qamil Osmani", të rregullohet çeshmja dhe të bëhet një park i vogël në rrugën "Fadil Rashiti".	Ramadan Rashiti banor i fshatit Petrovë	Plotësisht	
78.	Të bëhet rregullimi i "rrugës së kuqe" ose ndryshe rruga "Haxhi Zeka", gjithashtu të bëhet dhe ndërtimi i çerdhes.	Argjend Hysenaj banor i fshatit Petrovë	Plotësisht	
79.	Te rruga "Qamil Osmani" dhe "Nazim Bakiu" a do të ketë ndriqim? A do të rregullohet ujësjellësi dhe çerdhja? Gjithashtu edhe një kërkesë tjetër, kanalizimi i cili është në fshatin Petrovë të kontrollohet nga inspektorët e fushës.	Baki Rashiti banor i fshatit Petrovë	Plotësisht	
80.	Të rregullohet kanalizimi në fshatin Petrovë nga rruga "Xhemshir Xhemshiri" deri tek lagja "Hysenaj"	Asllan Beqaj banor i fshatit Petrovë	Plotësisht	
81.	Nga rruga "William Walker", të rregullohet trotuari që lidhet me rrugën "Qorr Ilazi". Kërkesa e radhës është për ujë të pijshëm, sa i përket ujësjellësit është e nevojshme të rivitalizohet vrella e Reçakut (ku së pari duhet të bëhet një analizë e ujit a mund të përdoret dhe sa banorë mund të furnizohen me atë ujë). Të rregullohet rruga "William Walker", nga ura e Reçakut e që më pas vazhdon nga Shtimja, pasi që ka shumë dëmtime. Në rrugën "Ahmet Kaqiku", tek pjesa e trotuarit, të bëhet një muri mbrojtës rreth trotuarit dhe ndriqimi.	Adem Ramadani banor i fshatit Reçak	Plotësisht	
82.	Të rregullohet ndriqimi në rrugën "24 Marsi"	Minush Brahimi banor i fshatit Reçak	Pjesërisht	

83.	Kanalizimi dhe ujësjellësi të rregullohen dhe të jenë primare në fshatin Reçak.	Skender Bajrami banor i fshatit Reçak	Pjesërisht	
84.	Një parking para shkollës së Reçakut. Në rrugën "2 Korriku", rivitalizimi i rrugës dhe vazhdimi i një segmenti në po të njëjtën rrugë.	Arsim Rama banor i fshatit Reçak	Pjesërisht	
85.	Rregullimi i shtratit të lumit pse ka mbetur në gjysëm kur 97% ka përfunduar dhe vetëm 3% ka mbetur? Në rrugën "De Rada", nuk mund të hyjmë as në shtëpitë tona nga makinat të cilat parkohen aty. Mungesa e ndriqimit dhe ulëseve tek Qendra Rinore.	Habib Haziri banor i Shtimes	Plotësisht	Rregullimi i shtratit të lumit do të bëhet nga Ministria
86.	Në rrugën "Ahmet Shtimja", shtrati i lumit është shumë i ulët, propozoj që një komision të dal dhe të bëjë matjen e gjendjes faktike.	Shaban Selmani banor i Shtimes	Pjesërisht	
87.	Në rrugën "Afrim Selmanaj", një muri e cila sapo ka filluar është çarë. Trotuari rreth lumit në rrugën e njëjtë, propozoj që të futet në buxhet për ndriqim.	Ibrahim Bungu banor i Shtimes	Plotësisht	Shtrati i lumit do të rregullohet nga Ministria
88.	Rruga "Sefë Kosharja", në një pjesë të lagjes është rregulluar, ndërsa për 200 metra nuk ka asfalt, ndriqim dhe kanalizim.	Argjend Velu banor i Shtimes	Plotësisht	
89.	Rregullimi i një korsie për ndalim të veturave tek shkolla "Emin Duraku", për prindërit e fëmijëve të cilët i dërgojnë në shkollë. Ndalimin e kamionëve të peshave të rënda nga ora 7 deri në orën 8 në mëngjes, derisa fëmijët shkojnë në shkollë.	Herolind Selmani banor i Shtimes	Plotësisht	

90.	Telat e energjisë elektrike të vendosen në tokë në lagjen "Zenun Beqa". Kockat e sheshit "Ahmet Shtimja" të rregullohen, po ashtu në këtë shesh të bëhet ndalimi i automjeteve dhe të bëhet me dije që vetëm banorët e asaj pjese kanë të drejtë të hyjnë.	Agim Beqa banor i Shtimes	Plotësisht	
91.	Rruga "Ahmet Shtimja" të vazhdojë punimet në shtratin e lumbit, po ashtu në të njëjtën rrugë të bëhet trotuari dhe të vendosen pengesa në atë rrugë.	Shpejtim Selmani banor i Shtimes	Plotësisht	
92.	Në rrugën "Zenun Beqa" kemi shqetësime me kanalizimin, mungesa e shportave të bërllokut dhe telat e energjisë elektrike të vendosen në tokë. Të vendosen wc publike në sheshin "Ahmet Shtimja".	Bujar Beqa banor i Shtimes	Plotësisht	
93.	Në rrugën "Anton Çeta", të bëhet shtegu i biçikletave dhe trotuari. Shtimja si qytezë e vogël duhet të ketë sinjalizim të rrugëve në të gjithë komunën.	Besnik Seferi banor i Shtimes	Plotësisht	
94.	Në rrugën "Enver Gashi" të bëhet një trotuar.	Zejnije Velu banor i Shtimes	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete për vitin 2024
95.	Kanalizimi prej Qendrës së Biznesit që kalon nga familjet Velu, Topalli dhe Jasharët, kur ka të reshura të shiut bëhet liqen sidomos tek Migrol Petroli. Puseta është tek Jasharët dhe del tek rruga "Jetë Hasani" ku ka shumë vërshime.	Veli Ademi banor i Shtimes	Plotësisht	
96.	Banor i këtij fshati theksoi se ka shumë nevojë për investim në fshat e me theks të veçantë në nevojën për ndërtimin e një shkolle të re pasi objekti në të cilin mbahet procesi mesimor tani nuk i përmbushë as nevojat elementare. Problem tjetër në këtë shkollë është edhe trotuari, rregullimi i të cilit është nevojë urgjente.	Nexhmedin Mehmeti banor i fshatit Vojnovc	Pjesërisht	Kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit

97.	Banor i këtij fshati theksoi se problem në këtë fshat është edhe mos hapja e kanaleve kulluese të ujit, ku pas çdo reshje të shiut krijohen vërshime e që problem për këta banorë është edhe çështja e rrugëve të arave ku kërkoj edhe asfaltimin e këtyre rrugëve	Arif Shabani banor i fshatit Vojnovc	Pjesërisht	
98.	Banor i këtij fshati theksoi se rregullimi i trotuarit në skaj të Lumit është nevojë e madhe për banorët pasi ata frekuentojnë këtë rrugë çdo ditë. Kërkesë tjetër e këtij banori ishte edhe ndriqimi dhe asfaltimi i rrugës Kurti.	Ismet Rifati banor i fshatit Vojnovc	Plotësisht	
99.	Banor i këtij fshati e bëri të ditur se Vojnoci meriton përkrahje më të madhe pasi është njëri ndër vendet i cili merret më së shumti me bujqësi dhe për këtë arsye meriton edhe përkrahje me subvencionim. Kërkesë tjetër e këtij banori është edhe kyçja në rrjetin elektrik të lapidarit i cili është ndërtuar nga vetë banorët e fshatit.	Musa Shabani banor i fshatit Vojnovc	Pjesërisht	
100.	Banorë i këtij fshati para të pranishmëve shprehu disa kërkesa: Mbjellja e disa fidanëve dhe barit në rrugën Ibrahim Shabani. Rregullimi i rrethojave të varrezave të cilat janë komplet të demoluara, Asfaltimi, ndriqimi dhe rregullimi i trotuarit në lagjen Kurti. Rregullimi i rrethojave të oborrit të shkollës. Ndarja e një shume të caktuar për mirëmbajtjen e fshatit.	Besart Aliu banor i fshatit Vojnovc	Pjesërisht	
101.	Banor i këtij fshati kërkoj zgjerimin e rrugës "Jashari", gjithashtu edhe rregullimin dhe hapjen e kanaleve për grumbullimin e ujit.	Gani Jashari banor i fshatit Vojnovc	Pjesërisht	
102.	Si banorë i këtij fshati kërkoj riparimin e urës dhe ndriqimin përgjatë saj.	Granit Ramadani banor i fshatit Vojnovc	Plotësisht	

Raporti është përgatitur nga: Gentiana Mehmeti

